



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.244/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sami Ahmeti, kandidat për asamble komunale nga radhët e e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Komunën e Obiliqit të parashtruar kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Obiliq, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR ankesa ZL.Anr.244/2025, e datës 17.10.2025, e parashtruar nga Sami Ahmeti, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Komunën e Obiliqit parashtruar kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Obiliq, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 17.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruesit të ankesës Sami Ahmeti, kandidatit për asamble komunale në Obiliq nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se ankesa ka të bëjë me disa probleme serioze që kanë ndodhur gjatë zgjedhjeve të fundit, përkatësisht ka pasur mungesë të votave në sistemin zgjedhor, pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kishin votuar në mënyrë të rregullt. Tutje, parashtruesi i ankesës shton se komisionerët me dashje kanë neglizhuar e favorizuar kandidatë të caktuar duke i shpërblyer me vota të paqena, më këtë rast i është shkaktuar dëm në së paku tri vendvotime. Disa nga qendrat e votimit me të cilat pretendon se ka pasur shkelje dhe duhet të hetohen janë këto qendra të votimit : 1502/03, 1502/04, dhe 1509/01 nuk janë regjistruar votat e familjarëve dhe miqve, të cilët kanë votuar në këto qendra. Vendvotimi në Milloshevë 1502/03– votat e mbi 20 familjarëve mungojnë në këtë qendër ; Vendvotimi 1502/04– votat e mbi 40 miq e familjarëve mungojnë këtu dhe se janë të gatshëm ta konfirmojnë së kanë votuar; Vendvotimi në Mazgit i Epërm 1509/01– mbi 30

miq që kanë qenë të gatshëm ta konfirmojnë se kanë votuar. Me tutje deklaroi se me dhjetëra qytetarë në vendvotime të lartcekura dhe në vendvotime të tjera janë të gatshëm që personalisht të vijnë ta konfirmojnë që kanë votuar edhe pse qytetarët e kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës në mënyrë të rregullt nuk figurojnë ato vota në faqen e publikimit të rasteve. Me këtë parashtruesi i ankesës, kërkon hetim të detajuar dhe verifikim të regjistrimit të votave në sistemin elektronik të KQZ, për të siguruar që të gjitha votat që janë hedhur, të regjistrohen në mënyrë të drejtë dhe të saktë si dhe rinumërim i tërësishëm në nivel komunal.

Si dëshmitar, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur deklaratën e Arif Pllana, vëzhgues nga subjekti politik LVV ku ka deklaruar se këto veprime dhe parregullsi të kësaj natyre kanë qenë evidente ku komisionerët ndryshe kanë lexuar emrat e fletëvotimeve dhe ndryshe kanë regjistruar votat në sistemin e rezultateve të KQZ. Sipas tij edhe komisionerët të tjerë deklarojnë se ka marrëveshje të kësaj natyre mes tyre.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, theksojnë se pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar më KKZ e komunës së Obiliqit lidhur me pretendimet e palës ankuese, Sami Ahmeti kandidat për asamble komunale në Obiliq nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) i cili pretendon se ka pasur mungesë të votave pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kanë votuar në mënyrë të rregullt në qendra të votimit të lartcekura në ankesë, pra në këto qendra të votimit i

mungojnë votat në rezultate pse qytetarët e kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës në mënyrë të rregullt, dhe kjo ka ndikuar në rrezikimin e rezultateve. Në përgjigje të KKZ-së sqarohet se sipas ligjit dhe rregullores së QKN-së dhe Numërimi i Votave është bërë nga 4 Numërues të cilët janë nga Subjektet Politike LVV, LDK, PDK dhe AAK ku gjithçka ka qenë në vëzhgimin e kamerave të sigurisë dhe është përcjellë edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike. Dëshmitari i cili në rolin e Vëzhguesit është i njëjti në të dyja rastet gjatë procesit të Numërimit nuk ka paraqitur asnjë vërejtje ndaj Numëruesve sepse Anëtarët e KKZ-së si dhe Trajnerët kanë qenë prezent gjatë gjithë procesit të Numërimit dhe nuk kanë marrë asnjë njoftim apo ankesë për ndonjë lëshim nga procedurat e numërimit dhe prezent gjatë procesit të numërimit kanë qenë të gjithë vëzhguesit e subjekteve tjera politike.

Andaj, KQZ pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese jep përgjigjet bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Tutje KQZ ka theksuar se rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në QKN, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore nr.16/2024 për

Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Bazuar në Rregullën Zgjedhore nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore neni 9, par.1 thekson se : Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilitdo Vendvotim ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV mirëpo pala ankuese nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike dhe nuk ka dhënë prova të mjaftueshme në lidhje me pretendimet e tij, duke përfshirë këtu : Formularët e Rezultateve të Subjekteve Politike, Libri i Votimit dhe deklarata e KVV etj. Po ashtu, mbështetja në pohime të familjarëve dhe miqve të caktuar sipas KQZ-së nuk është e

argumentuar, për me tepër vota është e fshehtë dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë si fakt provues. Pala ka bërë ankesë ndaj rezultateve mirëpo rezultatet ende nuk janë publikuar andaj në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, paneli vlerësoi se pretendimet ankimore se kandidati për Asamble Komunale nga subjekti politik i LVV në Obiliq se gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatë të kuvendit komunal, dhe pretendon se duhet të numërohen në QV : 1502/03, 1502/04 dhe 1509/01 nuk janë regjistruar votat e familjarëve të mi, të cilët kanë votuar në këto qendra në Milloshevë dhe Mazgit i Epërm. Këto pretendime Paneli vlerësoi si të pabazuara pasi që ankuesi nuk ka dëshmuar me prova konkrete pretendimet e tij edhe pse i referohet parregullsive gjatë numërimit të votave.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LQP-së në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe në Nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen thuhet se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Sami Ahmeti, kandidat për asamble komunale nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Obiliq, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur asnjë provë përkatësisht pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LQP-së në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Kështu që Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, dëshmitë e ofruara nuk janë të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LQP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se pretendimi i parashtruesit të ankesës se duhet të ketë rinumërim, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, andaj në rrethanat e rastit konkret ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZLAnr.244/2025 më datën 20.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.